



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-109

Prishtinë, më 13 maj 2013, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 13 MAJ 2013

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Glauk Konjufca, Petar Miletqi dhe Rasim Demiri, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Burim Ramadani, Myzejene Selmani, Sasha Milosavleviq dhe Myfera Shinik.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi dhe Skender Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Emrush Haxhiu, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca;

Nga zyra e Presidentit: Amir Haradinaj,

Nga OSBE-ja: Floriana Shala dhe

Nga NDI-ja: Rinor Beka.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Ai propozoi që pika 2.12 dhe 2.16 të hiqen nga rendi i ditës, me të cilën u pajtua Kryesia.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 29 prill 2013,
2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 29 prill 2013

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 29 prill 2013 pa vërejtje.

2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës

Kryesia, pasi i shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që Kuvendi gjatë kësaj jave t'i mbajë dy seanca dhe atë:

Mbledhja plenare më 16 maj 2013, me këtë:

Rend dite

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tregun dhe produktet e naftës në Kosovë,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, të ndryshuar dhe të plotësuar me ligjet nr. 03/L-221 dhe nr. 04/L-116,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen e burimeve të gazetarisë,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për transportin rrugor,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për sigurinë dhe shëndetin në punë,
9. Shqyrtimi i dytë i Projekt-rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës,
10. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2012,
11. Shqyrtimi i raportit vjetor të punës të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2012,
12. Shqyrtimi i raportit vjetor të Komisionit të Pavarur për Media për vitin 2012,
13. Shqyrtimi i raportit të punës së Institutit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2012,
14. Shqyrtimi i kërkesës së Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për miratimin e tarifave vjetore për vitin 2013,
15. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e një anëtari Komisionit të Pavarur për Media.

Mbledhja solemne më 17 maj 2013, me këtë:

Rend dite

14-vjetori i zhdukjes së atdhetarit dhe diplomatit të shquar të çështjes kombëtare, **Ukshin Hoti**.

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave

1. Zgjedhja e një anëtari joekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me çështjen e lartshënuar, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni për Buxhet dhe Financa, si Komision Funkcional, që ta shqyrtojë propozimin e Panelit Vlerësues të Bankës Qendrore të Kosovës për plotësimin e një pozite për anëtar joekzekutiv të Bordit të BQK-së dhe Kuvendit t’ia paraqesë raportin me rekomandime.

2. Kërkesa për seancë solemne në nderim të atdhetarit dhe diplomatit të çështjes kombëtare Ukshin Hoti, sipas kërkesës së deputetit Idriz Vehapi dhe të deputetëve nënshkrues

Kryesia vendosi që Kuvendit të mbajë mbledhje solemne në nderim të atdhetarit dhe diplomatit të shquar të çështjes kombëtare, Ukshin Hoti, më 17 maj 2013.

3. Kërkesa për debat parlamentar lidhur me strategjinë e Qeverisë së Kosovës për integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Republikën e Kosovës 2009-2015, sipas kërkesës së deputetit Xhevdet Neziraj dhe të deputetëve nënshkrues

Kryesia, pasi diskutoi për kërkesën e lartshënuar për debat parlamentar lidhur me strategjinë e Qeverisë së Kosovës për integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Republikën e Kosovës 2009-2015, sipas kërkesës së deputetit Xhevdet Neziraj dhe të deputetëve nënshkrues, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Kërkohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës që ta përgatisë një informatë lidhur me zbatimin e strategjisë për integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Republikën e Kosovës 2009-2015, para se Kuvendi të debatojë lidhur me këtë çështje.

4. Kërkesa e Komisionit Hetimor Parlamentar për zgjatjen e mandatit edhe për një muaj shtesë

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e lartshënuar, vendosi që Komisioni ta përfundojë mandatin që ia ka caktuar Kuvendi, pastaj nëse nuk arrin t’i kryejë punët, të parashtrijë kërkesë për zgjatjen e mandatit shtesë.

5. Kërkesa për formimin e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e një anëtari Komisionit të Pavarur për Media

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me çështjen e lartshënuar, këtë pikë e radhiti në rend dite për mbledhjen plenare të datës 16 maj 2013, si dhe nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

1. Kërkohet nga grupet parlamentare të Kuvendit që deri në seancën e radhës, më 16 maj 2013, t'i propozojnë deputetët për anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media.

2. Përbërja e Komisionit ad hoc duhet ta ketë këtë përbërje: GP i PDK-së 2 anëtarë, GP i LDK-së 2 anëtarë, GP VV 1 anëtar, GP i AAK-së 1 anëtar, GP i KKR-së 1 anëtar, GP i SLS-së 1 anëtar GP "6+" 1 anëtar dhe GP ZB 1 anëtar.

6. Njoftimi për formimin e Grupit Parlamentar "Zajednička Budućnost" ("Ardhmëria e Përbashkët")

Kryesia, në bazë të nenit 20 pika 2 të Rregullores së Kuvendit, u njoftua me vendimin e deputetëve për formimin e Grupit Parlamentar "Zajednička Budućnost" ("Ardhmëria e Përbashkët"), sipas kësaj përbërjeje:

1. Deputeti Goran Marinković, kryetar,
2. Deputeti Sasha Gjokiq, zëvendëskryetar,
3. Deputetja Biserka Kostiq, anëtare,
4. Deputeti Vesimir Saviq, anëtar,
5. Deputeti Boban Todorović, anëtar,
6. Deputeti Milivoje Stojanović, anëtar dhe
7. Deputeti Etem Arifi, anëtar.

7. Njoftimi i deputetit Hamza Balje për tërheqjen nga Grupi Parlamentar "6+"

Kryesia, në bazë të nenit 20, pika 2, të Rregullores së Kuvendit, u njoftua nga deputeti Hamza Balje se prej datës 29 prill 2013 është tërhequr Grupit Parlamentar "6+" dhe se në të ardhmen do të veprojë si deputet i pavarur.

8. Njoftimi i katër deputetëve për tërheqje nga Grupi Parlamentar i SLS-së

Kryesia, në bazë të nenit 20 pika 2 të Rregullores së Kuvendit, u njoftua nga deputetët: Milivoje Stojanović, Boban Todorović, Biserka Kostiq dhe Goran Marinković, se janë tërhequr nga Grupi Parlamentar i SLS-së.

9. Njoftimi i deputetit Sreten Ivanović për t'iu bashkuar Grupit Parlamentar të SLS-së

Kryesia, në bazë të nenit 20, pika 2, të Rregullores së Kuvendit, u njoftua nga deputeti Sreten Ivanović se prej datës 3 maj 2013 i është bashkangjitur Grupit Parlamentar të SLS-së.

Pikat shtesë:

1. Kërkesa e Grupit të Grave Deputete për alokimin e mjeteve për blerjen e Mamografit mobil

Për kërkesën e lartshënuar diskutuan: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, nënkryetar i Kuvendit; Adem Grabovci, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Burim Ramadani, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të KKR-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e lartshënuar, këtë çështje e shtyu për mbledhjen e radhës.

2. Kërkesa për mbulimin e shpenzimeve për mbajtjen e Lutjeve të Mëngjesit

Për kërkesën e lartshënuar diskutuan: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, nënkryetar i Kuvendit; Adem Grabovci, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e lartshënuar, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni për Buxhet dhe Financa që ta shqyrtojë kërkesën për mbulimin e shpenzimeve për mbajtjen e Lutjeve të Mëngjesit në Kosovë dhe Kryesisë së Kuvendit t'ia paraqesë rekomandimin lidhur me këtë çështje.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 12:05 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale